

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6302
E mërkurë, 28 prill 2021
çmimi 0.40 €

Kosova përkujton të pagjeturit dhe masakrën e Mejës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KA PËRFUNDUAR NUMËRIMI I VOTAVE TË ZGJEDHJEVE
PARLAMENTARE NË SHQIPËRI

RAMA VAZHDON TA QEVERISË SHQIPËRINË



Partia Socialiste (PS) ka fituar për herën e tretë zgjedhjet parlamentare në Shqipëri. PS-ja në zgjedhjet e 25 prillit ka fituar 74 mandate. Kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama, e ka nisur ditën e

martë me një shprehje të Michael Jordanit. "Po punove fort ia del. S'ka rrugë të shkurtra në jetë", ka shkruar Rama në rrjetet sociale. Partia Demokratike ka marrë 59 vende në

kuvendin e ri krahasuar me 46 që ka pasur në vitin 2017, kurse Lëvizja Socialiste ka pësuar humbje, pasi ka arritur të marrë vetëm katër mandate nga 19 që ka pasur në zgjedhjet e kaluara

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ

NGA DEFANSIVA TË KALOHET NË OFENSIVË DIPLOMATIKE PËR DIALOGUN

Politologu Belul Beqaj ka thënë se kryeministri Albin Kurti nuk ka asnjë arsye për t'iu shmangur vazhdimin të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova nga defansiva duhet të kalojë në ofensivë diplomatike duke promovuar superioritetin e

argumenteve në dialog karshi Serbisë. Beqaj ka vlerësuar se qeveria duhet të tregojë gatishmëri për ta implementuar obligimin e trashëguar nga dialogu, pavarësisht se Lëvizja Vetëvendosje e ka kundërshtuar formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe



OPINION

LIDHSHMËRIA NË MES TË LABORATORIT TË CERN-it DHE ATIJ TË FERMILABIT

Nga: Naim KRASNIQI, fizikan



AKTUALE

97 PËR QIND E ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIKË E DEKLAROJNË PASURINË

KURTI DHE PALMERI DISKUTOJNË PËR DIALOGUN



EKONOMI

BANKA BOTËRORE: PRITET RIMËKËMBJE GRADUALE EKONOMIKE NË KOSOVË

TRANSFORMIMI I PRONËS SHOOËRORE NUK KA ALTERNATIVË



SPORT

ARBËRIA MERR TRI PIKË TË ARTA KUNDËR FERONIKELIT, SOT ZHVILLOHEN KATËR NDESHJE

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçishtë-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KA PËRFUNDUAR NUMËRIMI I VOTAVE TË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË SHQIPËRI

Rama vazhdon ta qeverisë Shqipërinë

Partia Socialiste (PS) ka fituar për herën e tretë zgjedhjet parlamentare në Shqipëri. PS-ja në zgjedhjet e 25 prillit ka fituar 74 mandate. Kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama, e ka nisur ditën e martë me një shprehje të Michael Jordanit. “Po punove fort ia del. S’ka rrugë të shkurtra në jetë”, ka shkruar Rama në rrjetet sociale. Partia Demokratike ka marrë 59 vende në kuvendin e ri krahasuar me 46 që ka pasur në vitin 2017, kurse Lëvizja Socialiste ka pësuar humbje, pasi ka arritur të marrë vetëm katër mandate nga 19 që ka pasur në zgjedhjet e kaluara



Erdogani, Mitsotakisi, Di Maio dhe Salvini urojnë Ramën

Derisa zyrtarisht kreu i KQZ-së ka bërë me dije se PS-ja ka siguruar 74 mandate, kanë ardhur urimet nga ndërkombëtarët për kryeministrin Edi Rama.

Presidenti turk Taip Erdogan dhe kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis kanë uruar kryeministrin për këtë rezultat të arritur, që i siguron deri më tani mandatin e tretë qeverisës.

Urime për rezultatin e zgjedhjeve të 25 prillit Rama ka marrë edhe nga ministri i Punëve të Jashtme të Italisë, Luigi Di Maio dhe lideri i opozitës italiane, Matteo Salvini.

parlamentarizmit dhe në normalitet politik”, ka deklaruar Meta.

Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell dhe komisionari për Zgjerim, Oliver Varhelyi, përmes një deklaratë të përbashkët për media, u kanë bërë thirrje partive politike në Shqipëri që të pranojnë rezultatin e zgjedhjeve. “Ne inkurajojmë të gjitha palët e

përfshira në procesin e numërimit të votave të procedojnë me shpejtësi dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara. Të gjitha forcat politike duhet ta sigurojnë funksionimin efikas dhe demokratik të institucioneve në vend si rezultat i këtyre zgjedhjeve. Kjo përfshin përgjegjësinë për ta ndjekur parimin demokratik për ta

respektuar rezultatin e zgjedhjeve”, thuhet në deklaratë. Në zgjedhjet e përgjithshme të Shqipërisë të drejtë vote kishin 3.6 milionë qytetarë.

Qytetarët votuan për t’i zgjedhur 140 deputetët e parlamentit të ri dhe qeverinë e re që do ta udhëheqë vendin për katër vjetet e ardhshëm.

Në Shqipëri të dielën u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, për herë të dhjetë që nga nisja e pluralizmit politik dhe rënja e komunizmit në vend.

Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 48.59 për qind, përkatësisht 1 729 834 qytetarë.

Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore. Për krijimin e qeverisë, partia apo koalicioni fitues duhet të ketë së paku 71 mandate në Kuvendin e Shqipërisë.



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

TIRANË, 27 PRILL - Partia Socialiste (PS) në Shqipëri kryeson si forcë e parë në tetë qarqe të vendit, ndërkohë që mbi 96 për qind e kutive të votimit janë numëruar. Deri më tani Partia Socialiste rezultoi me 74 mandate, Partia Demokratike ka rritje krahasuar me zgjedhjet e kaluara, pasi deri më tani ka marrë 59 vende në kuvendin e ri krahasuar me 46 që ka pasur në vitin 2017. Ndërsa Lëvizja Socialiste ka pësuar humbje, pasi ka arritur të marrë vetëm katër mandate nga 19 që ka pasur në zgjedhjet e kaluara, ndërkohë PSD-ja e Tom Doshit ka marrë tri mandate.

Në një postim në rrjetin social “Facebook”, kryeministri i Shqipërisë, njëherësh kryetar i Partisë Socialiste, Edi Rama, e ka nisur ditën e martë me një

shprehje të Michael Jordanit. “Po punove fort ia del. S’ka rrugë të shkurtra në jetë”, ka shkruar Rama.

Ndërkaq presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se është meritë e tij që 25 prilli të ishte ditë e qetë dhe pa probleme dhe se kjo ditë i shërben demokracisë dhe stabilitetit në vend. “Edhe pse i vetëm përballë të gjithë institucioneve të kapura, ia arrita që 25 prilli të ishte një ditë e qetë, paqësore, pa skena dhune dhe me pjesëmarrjen tuaj masive për ta ushtruar të drejtën e votës”, u shpreh presidenti përmes një videomesazhi. Ai ka kërkuar maturi nga partitë politike në mënyrë që procesi të mbyllet qetësisht. “Sfida ime madhore, sidomos në dy vjetet e fundit, ka qenë që sovranit ta shprehë i lirë vullnetin e tij dhe që Shqipëria të rikthehet në shinat e Kushtetutës,

Hoxhaj e Limaj urojnë Ramën

Për fitoren e PS-së në zgjedhjet e 25 prillit në Shqipëri, Edi Rama ka marrë urime edhe nga kryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj dhe ai i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. “E uroj mikun tim shumë të çmuar, kryeministrin Edi Rama, për fitoren e madhe dhe të rëndësishme në zgjedhjet në Shqipëri. Fitorja e Edit është fitore edhe e Shqipërisë për shkak të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor dhe një provimi të madh që kanë dhënë shqiptarët ditën e diel. Fitorja e kryeministrit Rama

dhe PS-së tregon për punën dhe reformat e prekshme që ka bërë ai gjatë këtyre dy mandateve në Shqipëri. Uroj që rrugën e nisur për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Edi Rama ta përmbyllë gjatë këtij mandati të tretë që ia besuan shqiptarët”, ka shkruar Hoxhaj në urimin e tij. Edhe Limaj ka uruar popullin shqiptar për një proces të qetë demokratik. “Uroj fituesin e zgjedhjeve, kryeministrin e Shqipërisë dhe mikun tim Edi Rama, për rezultatin e arritur”, ka thënë Limaj.

Kosova përkujton të pagjeturit dhe masakrën e Mejës

Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës kanë përkujtuar të pagjeturit e luftës dhe masakrën e Mejës. Në Ditën e të Pagjeturve, ata janë zotuar se do të bëjnë çmos për ta zbardhur fatin e personave të pagjetur në Kosovë. Ata kanë bërë me dije se institucionet e Kosovës duhet të bëjnë çmos për të vendosur drejtësi për të gjitha krimet e Serbisë në Kosovë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 PRILL - Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës janë zotuar se do të bëjnë çmos për ta zbardhur fatin e personave të pagjetur në Kosovë. Në Ditën e të Pagjeturve, presidentja Vjosa Osmani, kryeparlamentari Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti kanë bërë homazhe te memoriali për të Pagjeturit në Prishtinë. Me këtë rast, presidentja Osmani ka thënë se kërkesa parësore e institucioneve të Kosovës do të jetë zbardhja e fatit të të zhdukurve me dhunë. "Sot e ripërsërisim që fati i gjithë Kosovës është i lidhur drejtpërsëdrejti me fatin e mbi 1 600 familjarëve e më të dashurve tanë. Sot, po ashtu, e përsërisim që në Kosovë liria do të ketë kuptim vetëm atë ditë kur të rikthehen të gjithë njerëzit tanë, vetëm atë ditë kur do të ketë drejtësi për secilin prej tyre, vetëm atë ditë kur plaga e hapur e gjithë këtyre familjarëve, por që është plagë jona e përbashkët, plagë e gjithë Kosovës, do të mund të mbyllet apo, së paku, të fillojë të shërohet për shkak se do të zbardhet fati i të gjithë të pagjeturve", ka theksuar Osmani.

E para e vendit në prani të të gjithë familjarëve që ishin të pranishëm, ka thënë se kjo asnjëherë nuk do të jetë vetëm barrë e tyre. Ajo ka thënë se zëri i familjarëve të të zhdukurve do

të dëgjohet dhe se kërkesa parësore themelore do të jetë zbardhja e fatit të më të dashurve tuaj. "I kujtojmë sot bashkërisht, për t'ia përkujtuar vetvetes sonë, gjithë rajonit dhe gjithë aleatëve tanë që për Kosovën nuk ka gjë më të rëndësishme sesa zbardhja e fatit të të zhdukurve me dhunë", ka theksuar presidentja Osmani.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se Kosova duhet të bëjë çmos për të vendosur drejtësi për krimet e Serbisë në Kosovë. "Shteti serb ishte përgjegjës për gjenocidin, vuajtjet dhe krimet që ia shkaktoi popullatës shqiptare, prandaj është obligim i çdo zyrtari të bëjë çmos që drejtësia të ndodhë dhe të vijë në vend pasi nuk mund të ketë qetësi pa drejtësi në Kosovë", ka thënë ai. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se Dita e të Pagjeturve na kujton se mungesa e përgjigjes për fatin dhe vendndodhjen edhe të 1 632 personave të zhdukur, si dhe mungesa e drejtësisë për mijëra viktima të luftës, vazhdojnë ta rëndojnë jetën e familjeve që edhe 22 vjet pas luftës jetojnë me dhimbje dhe me ankthin e pritjes. "Familjet e personave të zhdukur duhet ta dinë fatin dhe vendndodhjen e familjarëve të tyre të rrëmbyer dhe zhdukur dhunshëm gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe kjo duhet të bëhet me hapa të përshpejtuar. Andaj prioritet i qeverisë është angazhimi maksimal për zbardhjen e fatit dhe

vendndodhjes së gjithë personave të zhdukur", ka thënë Kurti. Ai ka kujtuar edhe masakrën e Mejës. "Më 27 prill Kosova përkujton masakrën e Mejës, masakrën më të madhe dhe çnjerëzore të kryer nga forcat policore serbe dhe ushtria jugosllave gjatë luftës së fundit në Kosovë. Me ndryshimet që kemi bërë në legjislacionin përkatës dhe plotësimet, po ashtu, të iniciuara gjatë këtyre ditëve, institucionet e drejtësisë duhet t'i ndjekin dhe t'i dënojnë në mënyrë meritore kryerësit e krimeve të përmasave gjenocidiale në Mejë dhe rrethinë dhe në të gjitha masakrat e tjera", është shprehur Kurti.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, së bashku me disa deputetë, kanë bërë nderime përpara memorialit për të pagjeturit në sheshin "Ibrahim Rugova" dhe në Mejë. Hoxhaj ka kërkuar nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, që përtej ndarjeve partiake, tema e të pagjeturve të

jetë prioritet në dialogun Kosovë - Serbi. "Kjo ditë është ditë e vështirë për të gjitha familjet në Kosovë, jo vetëm për familjarët e të pagjeturve, por për çdo familje në Kosovë. Sot është një ditë e rëndë dhe duhet ta japim maksimumin që në vitin e ardhshëm mos të mbesim në deklarata, por të kemi përparim konkret", ka thënë Hoxhaj. Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka kërkuar nga institucionet të bëjnë më shumë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. "Sot e 22 vjet shumë familjarëve nuk u përfundoj ankthi i pritjes për ndonjë lajm për më të dashurit e tyre e që ende nuk dinë se ku prehen.

Institucionet e Kosovës duhet të angazhohen që ankthi i tyre të marrë fund, që sadopak t'iu zbutet dhimbja. Çështja e të pagjeturve mbetet ende plagë e hapur jo vetëm për familjarët, por për gjithë shoqërinë dhe shtetin tonë", ka thënë ai.

Abdixhiku ka kujtuar edhe masakrën e Mejës, ku janë vrarë e masakruar 376 civilë shqiptarë. "Masakra e Mejës, 22 vjet më parë, ishte ditë e dhimbjes, por edhe ditë e kthesës historike, ditë e cila e mobilizoi botën e civilizuar demokratike për t'u bërë pjesë e përpjekjeve të mëdha të popullit të Kosovës për liri", ka thënë ai.

Në ditën e përkujtimit të krimit gjenocidar në Mejë, apel për mobilizim

Masakrën e Mejës e ka përkujtuar Qendra Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur. "Në ditën e sotme përkujtojmë njërin ndër masakrat më mizore që ndër morën forcat e armatosura të Serbisë gjatë zbatimit të politikës së gjenocidit në Kosovë. Më 27 prill 1999, në afërsi të fshatit Korenicë dhe tek udhëkryqi Meje-Orize, forcat e armatosura serbe bënë ndarjen e meshkujve nga kolona e civilëve shqiptarë që dëboheshin për në Shqipëri dhe ekzekutuan 374 meshkuj nga moshë 13 deri në moshën 90-vjeçare", është thënë në deklaratën e "Qendrës së Gjenocidit në Kosovë - Plagë e Hapur".

Po në këtë deklaratë është thënë se krimi i gjenocidit në masakrën e Mejës u shoqërua me strategjinë serbe të fshehjes së gjurmëve. "Vetëm një pjesë e kufomave kanë mundur të gjenden e të identifikohen. Një

pjesë e madhe e tyre është bartur me kamionë në pjesë të brendshme të Serbisë për t'u varrosur në varreza masive ose për t'u djegur, në mënyrë që të fshihen gjurmët e krimit. Fatkeqësisht, 22 vjet pas këtij krimi monstruo, kriminelët që kryen gjenocid ndaj shqiptarëve në Kosovë janë në krye të strukturave politike, ushtarake dhe policore të Serbisë, ndërsa familjarët e viktimave ende presin ndriçimin e fatit të atyre që konsiderohen të zhdukur! Në këtë ditë përkujtimi Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" kërkon një mobilizim të përgjithshëm politik, diplomatik dhe mediatik që krimi i gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës të njihet botërisht si krim i gjenocidit dhe përgjegjësit për këtë krim të ballafaqohen me drejtësinë", theksohet në deklaratën e "Qendrës së Gjenocidit në Kosovë - Plagë e Hapur".





FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ

Nga defansiva të kalohet në ofensivë diplomatike për dialogun

Politologu Belul Beqaj ka thënë se kryeministri Albin Kurti nuk ka asnjë arsye për t'iu shmangur vazhdimin të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova nga defansiva duhet të kalojë në ofensivë diplomatike duke promovuar superioritetin e argumenteve në dialog karshi Serbisë. Beqaj ka vlerësuar se qeveria duhet të tregojë gatishmëri për ta implementuar obligimin e trashëguar nga dialogu, pavarësisht se Lëvizja Vetëvendosje e ka kundërshtuar formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË 27 PRILL - Politologu Belul Beqaj ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës nga defansiva duhet të kalojë në ofensivë diplomatike në raport me dialogun me Serbinë. Ai ka thënë se kryeministri Albin Kurti në takim me përfaqësuesit e BE-së dhe të ShBA-së duhet të promovojë superioritetin e argumenteve në dialog karshi Serbisë. Në këtë intervistë dhënë

gazetës "Epoka e re", Beqaj ka thënë se Kurti nuk e ka asnjë justifikim për t'iu shmangur vazhdimin të dialogut. "Zotëri Kurtin asnjë arsye për shmangie nga vazhdimi i dialogut nuk e justifikon. Kosova duhet të koeporojë dhe koordinojë takimet brenda dhe jashtë për të kaluar nga defansiva e trashëguar në ofensivë diplomatike duke promovuar superioritetin e argumenteve në dialog karshi Serbisë. Besoj se ky takim është vetëm identifikues rreth

pozicioneve të dialoguesve, pra nuk pres veprime konkrete, por vetëm diagnostifikim të pozicioneve dhe synimeve", ka thënë Beqaj. Sipas tij, Kurti duhet të jetë i hapur me partnerët ndërkombëtarë dhe duhet t'i pranojë obligimet e mëparshme të procesit të dialogut. "Z. Kurti duhet të jetë i hapur para zyrtarëve evropianë për gatishmërinë e qeverisë për ta implementuar obligimin e trashëguar nga pushtetet e mëparshme,

pavarësisht se LV-ja e ka kundërshtuar formimin e AKS-së. Qeveria Kurti duhet të angazhohet për vazhdimin e dialogut për aq sa ka gatishmëri të palëve për të shkuar në drejtim të njohjes reciproke. Nëse palët ngulin këmbë vetëm për 'normalizim' dhe 'ndërmjetësim dhe lehtësim' të vazhdimin të dialogut, ai duhet të sillet konform rrethanave", është shprehur Beqaj.

Beqaj ka kritikuar Kurtin për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë. Ai ka bërë me dije se ky veprim i Kurtit do të përdoret nga kundërshtarët e pavarësisht së Kosovës. "Së pari, kjo do të përdoret si shkas nga politikanët e Serbisë dhe Rusisë që t'i akuzojnë shqiptarët për idenë e bashkimit kombëtar, ndërsa Serbia synon bashkimin e Republikës serbe dhe veriut të Kosovës në Serbinë e Madhe.

Pra, Serbia shfrytëzon votimin si shkas për t'i akuzuar shqiptarët për tendencën e 'bashkimit kombëtar', ndërsa në anën tjetër presidenti serb merr 'meritat' për bashkimin e serbëve në një shtet, gjoja se si pasojë e veprimit të shqiptarëve", ka deklaruar Beqaj.

"Epoka e re": Z. Beqaj, po bëhet një muaj që qeveria Kurti ka marrë detyrën, por ende nuk e ka paraqitur planin qeverisës. Cili është vlerësimi juaj për punën e deritashme të kësaj qeverie?

Beqaj: Vonesën mund ta arsyetojë vetëm plani efektiv, eficientë që e ka diagnostifikuar gjendjen reale, prioritetet dhe mundësitë e implantimit në përputhje me kapacitetet reale. Përndryshe, vonesa është fakt i paanashkalueshëm që flet për faktin se qytetarët kanë votuar më shumë kundër ish-



pushteteve sesa për LV-në e cila nuk e ka sjellë planin qeveritar deri sot, ndonëse është dashur ta kishte para zgjedhjeve! Prandaj, vonesën e planit qeveritar mund ta arsyetojë vetëm një plan gjithëpërfshirës me kapacitete të qarta me prioritete dhe implementuese.

“Epoka e re”: Kritikat kryesore ndaj qeverisë kanë të bëjnë me mospërkrahimin e ndonjë vaksine kundër Covidit. A ka mundur të bëjë më shumë në këtë drejtim qeveria?

Beqaj: Besoj se të gjitha qeveritë e deritanishme në kohën e pandemisë kanë qenë të interesuara për të siguruar vaksina kundër Covidit, por nuk kanë pasur sukses për shkaqe të ndryshme. Problemi kryesor qëndron në faktin se qeveria Hoti dhe Kurti, në vend se të veprojnë në mënyrë të bashkuar për sigurimin e vaksinave, veprimet i kanë ndërmarrë ndaras dhe në dëm të njëra-tjetrës, prandaj kanë vonuar sigurimin e vaksinave për qytetarët që po i ndiejnë pasojat e këtij politizimi.

“Epoka e re”: Kryeministri Kurti është kritikuar edhe për pjesëmarrjen e tij në zgjedhjet

parlamentare të Shqipërisë. Si e keni parë këtë veprim të tij?

Beqaj: Mendoj se pjesëmarrja e kryeministrit Kurti në zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë nuk ishte veprim i duhur për disa arsye. Do t'i veçoja dy. Së pari, kjo do të përdoret si shkak nga politikanët e Serbisë dhe Rusisë që t'i akuzojnë shqiptarët për idenë e bashkimit kombëtar, ndërsa Serbia synon bashkimin e Republikës Serbe dhe veriut të Kosovës në Serbinë e Madhe. Pra, Serbia shfrytëzoi votimin si shkak për t'i akuzuar shqiptarët për tendencën e “bashkimit kombëtar”, ndërsa në anën tjetër presidenti serb merr “meritat” për bashkimin e serbëve në një shtet, gjoja se si pasojë e veprimit të shqiptarëve?! Së dyti, pjesëmarrja e kryeministrit në zgjedhje fuqizon mendimet e disa kritikeve se Albin Kurti pretendon për t'u shndërruar si lider gjithëkombëtar para se të dëshmohej lider i shtetit të Kosovës, për të cilën i ka marrë votat.

“Epoka e re”: Në muajin tjetër pritet të fillojë dialogu Kosovë - Serbi. Pritni të ndryshojë diçka në këtë proces?

Beqaj: Zotëri Kurtin asnjë arsyesim për shmangie nga

vazhdimi i dialogut nuk e justifikon. Kosova duhet të koeporojë dhe koordinojë takimet brenda dhe jashtë për të kaluar nga defansiva e trashëguar në ofensivë diplomatike duke promovuar superioritetin e argumenteve në dialog karshi Serbisë. Besoj se ky takim është vetëm identifikues rreth pozicioneve të dialoguesve, pra nuk veprime konkrete, por vetëm diagnostifikim të pozicioneve dhe synimeve.

“Epoka e re”: Çfarë hapash duhet të ndërmarrë Kosova që të jetë e përgatitur në këtë proces?

Beqaj: Kurti duhet të jetë i hapur para zyrtarëve evropianë për gatishmërinë e qeverisë për ta implementuar obligimin e trashëguar nga pushtetet e mëparshme, pavarësisht se LV-ja e ka kundërshtuar formimin e AKS-së. Qeveria Kurti duhet të angazhohet për vazhdimin e dialogut për aq sa ka gatishmëri të palëve për të shkuar në drejtim të njohjes reciproke. Nëse palët ngulin këmbë vetëm për “normalizim” dhe “ndërmjetësim dhe lehtësim” të vazhdimin të dialogut, ai duhet të sillet konform rrethanave!

Kurti dhe Palmeri diskutojnë për dialogun

PRISHTINË, 27 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka diskutuar me

zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Shtetit, Matthew Palmer dhe ambasadorin amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Njoftimi për këtë bisedë është bërë nga ana e ambasadorit Kosnett përmes një postimi në rrjetin social “Twitter”, ku ka theksuar se “procesin e dialogut i udhëhequr nga BE-ja mbetet thelbësor për suksesin ekonomik të Kosovës dhe integrimin euroatlantik”.

Përpjekjet për vazhdimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë janë shtuar. Të hënën në Bruksel ka qëndruar presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ndërsa të martën për takime me zyrtarët e lartë të BE-së, udhëton kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, tha se pret që sa më shpejt të arrihet një marrëveshje për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës e Serbisë, sado e vështirë që të duket arritja e saj.

Pas bisedës me presidentin Vuçiq, Borrell e përmendi 11 majin datë të mundshme për rifillimin e dialogut. Por, përmes një reagimi në Prishtinë, zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, tha se për datë nuk është marrë vesh me zyrën e kryeministrit të Kosovës.

Ndërkohë, Shtetet e Bashkuara mbeten të angazhuara për mbështetje të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre të integritimit evropian dhe anëtarësimit në institucione kyçe evropiane dhe auroatlantike, thuhet në një deklaratë të zëdhënësit të Departamentit të Shtetit, Ned Price.

Në dokument, zëdhënësi Price shpreh mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për dialogun me ndërmjetësimin e BE-së dhe u bën thirrje palëve të riangazhohen në proces me një frymë të nevojës urgjente për t'i adresuar temat teknike dhe politike.

“Ne do të punojmë me Serbinë dhe Kosovën për t'i zbatuar angazhimet e Uashingtonit në mbështetje të synimeve për normalizim të plotë”, thuhet në deklaratë.

Deklarata vijon më tej se



“Shtetet e Bashkuara mbeten të gatshme t'i mbështesin përpjekjet për një marrëveshje detyruese, gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, të bazuara te njohja e ndërsjellë, e cila do të shërbejë si themel për bashkëpunim dhe begati të qëndrueshme”.

Procesi i dialogut Kosovë - Serbi ka nisur në vitin 2011 me bisedimet për çështje teknike, ndërkaq në vitin 2012 kishte evoluuar në bisedime politike

për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, me përfaqësim të nivelit të lartë politik, ndërmjet kryeministrave dhe presidentëve të të dy vendeve. Gjatë dhjetë vjetëve të dialogut Kosovë - Serbi besohet se janë arritur mbi 30 marrëveshje, ndonëse autoritetet në Prishtinë dhe në Beograd flasin me shifra të ndryshme për këto marrëveshje.

Në mesin e marrëveshjeve të arritura është edhe ajo për

Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe për formimin e së cilës tashmë ekziston kontesti ndërmjet vetë palëve që e kanë arritur atë. Bashkimi Evropian synon të arrijë një marrëveshje gjithëpërfshirëse në të cilën do të zgjidheshin të gjitha çështjet mes dy vendeve. Pas një pezullimi gati dyvjeçar, bisedimet ndërmjet dy vendeve gjatë vitit 2020 patën rifilluar, por ato sërish u ndërprejnë për shkak të zgjedhjeve në Kosovë që u mbajtën më 14 shkurt.

MEJA DHE HAGA



Shkruan: Ismail SYLA

1. Lëndina e Lotëve!
Mejë, 27 prill 1999
339 burra, gra, pleq e të rinj
38 fëmijë!
Gjithsej 377!
Krimi ka një adresë:
Momir Stojanoviç & Co!
Kështu shkruan miku im Ismet Sopi në profilin e tij në 'Facebook'.

2. Çka t'i shtohet më shumë këtij fakti veç konstatimit se Gjykata Speciale e Hagës përkatësisht Prokuroria e Gjykatës Speciale me akuzimin dhe arrestimin e padrejtë të luftëtarëve të lirisë, po krijon precedent dhe premisa të reja për ta ripërkufizuar kuptimin e togfjalëshave "krime lufte" dhe "krime kundër njerëzimit". Secila masakër prej 400 syresh të kryera në Kosovë nga forcat policore dhe ushtarake serbe në vitet 1998, 1999 përmbajnë viktima shqiptare të vrara e të shpërfytyruara dyfish e trefish më shumë se numri i atyre që kanë shkruar dëshmi kundër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që gjoja paskan kryer "krime kundër njerëzimit".

3. Të kujtojmë vrasjen e 8 mijë burrave në Srebrenicë (korrik 1996) nga shteti i Serbisë në "zonën e mbrojtur" dhe faktin që Serbia në juridiksionin ndërkombëtar lirohet nga akuza për kryerje të gjenocidit. Duke mos qenë "hapësirë e mbrojtur" Srebrenica u bë kasaphana më e madhe në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore.

Në vitet 1998, 1999 Kosova nuk ishte as "zonë e mbrojtur" (UNPROFOR i Bosnjës) as "hapësirë e mbrojtur" hapësirë rreptësisht e mbrojtur nën ombrellën e NATO-s brenda së cilës as zogjtë nuk do të fluturonin të lirë, e lëre më të bëheshin krime të përmasave të Srebrenicës, ose të Likoshanit, Çirezit, Prekazit, Izbicës, Rezallës, Reçakut, Krushës, Poklekut, Mejës e shumë e shumë masakrave tjera anembanë Kosovës.

4. Sipas trajtimit që Prokuroria Speciale e Hagës u bën luftëtarëve të lirisë në burgun e Hagës në fjalorët e rëndomtë, në ata enciklopedikë, juridikë, sociologjikë dhe politikë duhet ndryshuar dhe plotësuar kuptimi i nocioneve "krime të luftës" dhe "krime kundër njerëzimit" dhe të përfshihen edhe elementet: ta shohësh dikë me sy të shtrembër, të jesh rastësisht në afërsi të dikujt, e aq më shumë ta kërcënosh dikë me tundje të gishtit tregues, e mos e jep zot ta pickosh ose ta shkelësh padashur këmbën e dikujt ose ta shtysh dikë me bërryl.

Ndoshta këto elemente që mund të bëjnë ri-përkufizimin e nocioneve "krime lufte" dhe "krime kundër njerëzimit" bënë që njëri nga mbrojtësit e të akuzuarve në Hagë të

shprehet në një seancë të procedurës paraprake jo edhe pa mllef për mënyrën se si Prokuroria nuk ua vë në dispozicion avokatëve disa nga materialet dhe deklaratat që rëndojnë mbi të akuzuarit shqiptarë, luftëtarë të lirisë: "Ne kemi dëgjuar nga Prokuroria shumë herë që thotë: - 'Oh, ne jemi shumë të shqetësuar dhe duam të sigurojmë drejtësinë e këtyre procedurave'. Por ne nuk e besojmë këtë, sepse çdo metodologji e përdorur nga Prokuroria është një lloj taktike që në juridiksionin nga vij unë do të çonte në ndëshkim nga Gjykata. (Cituar sipas avokatit Ben Emmerson në seancën e procedurës paraprake të 16 shkurtit 2021).

5. Vërejtja e avokatit që vjen nga juridiksioni i Britanisë së

Madhe është tregues më i mirë, që po u përkthye në gjuhë politike dhe eseistike, kuptohet sipas opinionit tim, do të thotë: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi po të ishin qytetarë të shtetit britanik, po të ishin francezë, holandezë, suedezë, izraelitë, e me pas dashtë zoti që të ishin shtetas amerikanë, ju nuk do të mund të sillshit me ta, siç silleni me ta, vetëm pse ata janë shqiptarë.

Pra, Prokuroria e Hagës sillet si e tillë, sepse ata janë shqiptarë, luftëtarë lirie, njerëz prapa të cilëve nuk qëndron dhe nuk e ngre zërin asnjë institucion shtetëror i Republikës së Kosovës.

Së paku për të mos lejuar shkeljen e të drejtave të tyre elementare.

E, mbrojtja shtetërore e të drejtave të qytetarëve të saj të arrestuar, nuk do të thotë ndërhyrje në drejtësi.



Diskutohet për projektet që Këshilli i Evropës zbaton në fushën e të drejtave të njeriut



PRISHTINË, 27 PRILL (ER)- Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim kryetarin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, Frank Power dhe bashkëpunëtorët e tij. Power ka potencuar njëmbëdhjetë projekte që Këshilli i Evropës zbaton në fushën e të drejtave të njeriut, për sundim të ligjit, trafikim të qenieve njerëzore etj. Përfaqësuesit nga Zyra e Këshillit të Evropës diskutuan për rëndësinë e infrastrukturës më të mirë

ligjore lidhur me sinjalizuesit dhe ofruan ekspertizë për angazhim në konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurisë, si dhe shprehën mbështetjen për projekte të tjera të cilat ndërlihen me qasje më të lehtë në gjykata, digjitalizim të sistemit të drejtësisë dhe përdorim në teknologjinë e informacionit në gjykata si dhe asistencë ndaj viktimave të dhunës. Ministri e Drejtësisë ka njoftuar për një takim që po mbahet me mbështetësit e Ministrisë së Drejtësisë për

finalizim të prioritetëve dhe, po ashtu, njoftoi lidhur me veprimet për rishikimin funksional, vetingun, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimet e luftës dhe dhunën në familje. Lidhur me sinjalizimin, ministri Haxhiu i ka njoftuar mysafirët se është kompletuar rregullorja e sinjalizuesit, e cila brenda javës do të miratohet edhe në qeveri. Për zotimet e shprehura, palët u pajtuan për bashkëpunim të mëtutjeshëm.

Policia pranon donacion pajisje për digjitalizimin e dosjeve për personat e pagjetur

PRISHTINË, 27 PRILL (ER)- Në një ceremoni të organizuar të martën në ambientet e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, Policia e Kosovës ka pranuar një donacion me pajisje për

digjitalizimin e dosjeve për personat e pagjetur. Ky donacion korrespondon me Ditën e Personave të Pagjetur në Kosovë dhe me këtë rast Policia e Kosovës ka shprehur

konsideratë dhe ka falënderuar partnerët për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme. "Ky donacion është i një rëndësie të veçantë për punën e policisë për gjetjen, identifikimin

dhe administrimin e rasteve të personave të pagjetur përmes një procesi të digjitalizimit të këtyre dosjeve", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.



97 për qind e zyrtarëve të lartë publikë e deklarojnë pasurinë

Nga gjithsej 4 892 zyrtarë të lartë publikë, 4 783 zyrtarë kanë bërë deklarin e pasurisë në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 PRILL - Në pajtim me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave, procesi i deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë ka përfunduar më 31 mars 2021. Duke aplikuar rekomandimet e institucioneve përgjegjëse

për respektimin e masave të mbrojtjes nga pandemia Covid-19, procesi i deklarimit të pasurisë është realizuar nëpërmjet pranimit të formularëve të deklarimit të pasurisë në mënyrë elektronike.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka njoftuar se prej gjithsej 4 892 zyrtarëve të lartë publikë, deklarimin vjetor të pasurisë e kanë bërë gjithsej 4 783 zyrtarë të lartë publikë ose 97.77 për qind, duke

përmbyllur procesin e deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë.

Nga numri i përgjithshëm prej 4 892 të zyrtarëve të lartë publikë që kanë pasur për

obligim ta deklarojnë pasurinë, 4 783 zyrtarë të lartë publikë kanë bërë deklarin e pasurisë brenda afatit të rregullt ligjor, 56 zyrtarë të lartë publikë kanë

deklaruar pasurinë pas afatit të rregullt ligjor, 28 nga zyrtarët nuk e kanë deklaruar pasurinë me arsye, ose kanë deklaruar pas afatit, me arsyet e cekura, ndërsa 25 prej tyre nuk e kanë deklaruar pasurinë deri më tani.

Përveç deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë, me ndryshimet që kanë ndodhur në institucionet publike, këtë vit, Agjencia Kundër Korrupsionit, ka pranuar një numër të konsiderueshëm të formularëve të deklarimit të pasurisë me rastin e marrjes së detyrës zyrtare si dhe me rastin e përfundimit të detyrës zyrtare.

Tetë të vdekur dhe 194 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 PRILL - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 2 285 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave rezultojnë 194 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të të vdekurve si pasojë e këtij



virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Drenas një rast (69 vjeç), Ferizaj një rast (74 vjeç), Leposaviq një rast (68 vjeç),

Prishtinë një rast (75 vjeç), Prizren një rast (70 vjeç), Skenderaj një rast (72 vjeç), Viti një rast (76 vjeç), Vushtrri një rast (92 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 104 390 raste nga 524 588 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 148 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 599 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 92 571 raste, kurse numri i rasteve aktive është 9 671.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 47 raste, Prizren 16 raste, Ferizaj 15 raste, Klinë 15 raste, Leposaviq 13 raste, Vushtrri 11 raste, Skenderaj 8 raste, Pejë 7 raste, Gjilan 6 raste, Kaçanik 6 raste, Mitrovicë 6 raste, Rahovec 6 raste, Fushë-Kosovë 5 raste, Istog 5 raste, Podujevë 4 raste, Shtime 4 raste, Drenas 3 raste, Lipjan 3 raste, Malishevë 3 raste, Viti 3 raste, Hani i Elezit 2 raste, Obiliq 2 raste dhe me nga një rast komunat Gjakovë, Kamenicë, Shtërpçë dhe Suharekë.

Rishpallet konkursi për rekrutimin e 16 prokurorëve

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës, i udhëhequr nga Jetish Maloku, ka zhvilluar mbledhjen e 198 me radhë, e cila është mbajtur online dhe në përputhje me të gjitha masat mbrojtëse kundër pandemisë Covid-19, me ç'rast janë miratuar një sërë aktesh dhe çështjesh procedurale. Fillimisht u miratua raporti i mekanizimit përcjellës ndërinstucional për nëntë veprat penale karakteristike, i cili paraqet një tërësi të harmonizuar të të dhënave vjetore për veprimet prokuroriale gjatë vitit 2020. Anëtarët e Këshillit Prokurorial miratuan edhe

një raport tjetër vjetor të rëndësishëm për zhvillimet e sistemit prokurorial, atë të Komisionit Mbikëqyrës për zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, të cilët theksuan se shënon një progres të konsiderueshëm në krahasim me vitin 2019 edhe përkundrejt gjendjes së krijuar përgjatë një viti pandemik, si dhe ky komision u plotësua me caktimin e kryesuesit të tij, Veton Shabani, i cili njëkohësisht është zëvendëskryesues i KPK-së.

KPK-ja mori vendim për rishpalljen e konkursit publik

për rekrutimin e 16 prokurorëve në gjashtë prokurori themelore të vendit dhe me qëllim të kompletimit të procedurave, u themeluan Komisioni për Rekrutim dhe Komisioni për Rishqyrtim, si dhe u caktua administratori i provimit.

Gjithashtu, janë themeluar dy panele vlerësuese për rastet disiplinore ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore të Gjakovës dhe një në atë të Prizrenit.

Gjatë këtij takimi anëtarët e KPK-së, pas kërkesës dhe propozimit të ushtruesit të detyrës së drejtorit të Sekretariatit të KPK-së, morën vendim për aprovimin e dy



kërkesave që kanë të bëjnë me aktivitetet për realizimin e Planit të Personelit për vitin 2021.

Në përfundim të takimit të sotëm, Këshilli Prokurorial i

Kosovës mori vendim që t'i propozojë Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për lirim nga detyra të dy prokurorëve me rastin e pensionimit të tyre.

Ferizaj shënoi Ditën e Personave të Zhdukur

FERIZAJ, 27 PRILL (ER) - Me një aktivitet simbolik, të organizuar nga të rinjtë e Kuvendit të të Rinjve në Ferizaj, me mbështetje nga Sektori i Rinisë, Komuna e Ferizajt dhe Shoqata e Familjeve e Personave të Pagjetur në Ferizaj është shënuar 27 prilli - Dita Kombëtare e Personave të Zhdukur.

Nënkryetari i Ferizajt, Arton Gavazi, së bashkë me të rinjtë e Kuvendit të të Rinjve dhe familjarë të personave të

pagjetur, morën pjesë në aktivitetin që ishte dizajnuar në formë të tillë ku përmes pikëpyetjes, shtrohej pyetja për fatin e të pagjeturve si dhe bën homazhe në obeliskun e ngritur ditë më parë nga Komuna e Ferizajt, dedikuar të pagjeturve të Komunës së Ferizajt. "Të pagjeturit janë plagë e shoqërisë sonë dhe deri në zbardhjen e fatit të tyre nuk duhet të reshtet në asnjë moment", ka thënë nënkryetari Gavazi.



Haziri merr dhuratë një pikturë me portretin e tij



Gjilan, 27 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim pune nxënësen e Shkollës së Mesme të Artit "Adem Kastrati" në Gjilan, Elmira Abazi, e cila i

dhuroi portret pikturën e kryetarit Haziri. "E falënderoj shumë për punën dhe angazhimi që ajo dhe të gjithë nxënësit e kësaj shkolle po bëjnë për çdo ditë. Gjilani ka

ndryshuar dhe vërtet po e mban me të drejtë epitetin e qendrës së kulturës. Aktiviteti dhe energjitë e reja janë detyrë që Komuna e Gjilanit të mbështetet pafundësisht", ka thënë Haziri.

Ndahet parcela për ndërtimin e stacionit policor në 'Kodrën e Trimave'

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Me vendim të Kuvendit Komunal të Prishtinës është ndarë parcelë nga prona komunale, në të cilën do të ndërtohet stacioni policor në "Kodrën e Trimave". Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se Drejtoria e Pronës, në bashkëpunim me

Drejtorinë e Inspektionit dhe Policinë e Kosovës, kanë filluar zbatimin e vendimit për lirim të kësaj parcele, e cila ka qenë e uzurpuar. "Objektet brenda kësaj parcele do të rrënohen ashtu që të procedohet ndërtimi i stacionit policor", ka thënë Ahmeti.



Disa fshatra të Podujevës përfshihen nga zjarret

PODUJEVË, 27 PRILL (ER) - Ditët e fundit disa sipërfaqe me pyje në disa fshatra të Komunës së Podujevës janë përfshirë nga zjarret.

Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Vigan Salihu, bashkë me zyrtarë të kësaj drejtorie, kanë dalë në terren për ta parë gjendjen nga afër. Ai ka thënë se komuna është në koordinim të vazhdueshëm me ekipet e zjarrfikësve, të cilët po bëjnë përpjekje maksimale për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit.

Salihu ka thënë se lokalizimin e zjarrit po e vështirëson era e fortë që po frynë, e cila po përshpejton përhapjen e zjarrit. Zona më e prekur nga zjarri është fshati Reqicë, vendi i quajtur Lluqefc, si dhe Kërrshi i Uglarit me rreth 15 hektarë dhe zonat përreth. Drejtori Salihu ka bërë apel te të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës që të jenë më të kujdesshëm dhe të kontribuojnë për ruajtjen e mjedisit si dhe t'i lajmërojnë institucionet në rast se shohin zjarr në pyje.



Banka Botërore: Pritet rimëkëmbje graduale ekonomike në Kosovë

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 27 prill - Pas një recesioni historik, pritët rimëkëmbje graduale ekonomike në Kosovë dhe tërë Ballkanin Perëndimor, është thënë në raportin më të ri të Bankës Botërore.

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia - gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor - pritët të kenë sërish rritje ekonomike gjatë vitit 2021 pas recesioni të viti 2020, më i rëndi i regjistruar ndonjëherë në rajon. "Pas goditjes së rëndë ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19, që rezultoi me një tkurrje të aktivitetit ekonomik të rajonit në një nivel të vlerësuar prej -3.4-përqindësh në vitin e kaluar, rajoni i Ballkanit Perëndimor pritët të rritet me 4.4 për qind në vitin 2021. Më tutje, ritmi i rritjes ekonomike pritët të stabilizohet në 3.7 për qind përgjatë vitit 2022 dhe 2023, ku efektet përcjellëse të pandemisë do të vijojnë t'i ngadalësojnë investimet dhe punësimin në rajon", është thënë në raport.

Linda Van Gelder, drejtoreshë Rajonale e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, ka thënë se pasojat shkatërruese të pandemisë në sistemin shëndetësor dhe në ekonomi

do të vazhdojnë të ndihen. "Ne po shohim vërtet disa trendë pozitivë në rajon si rezultat i masave të shpejta të ndërmarra nga shumë vende për t'i frenuar pasojat e rënda të pandemisë, por pasojat shkatërruese të pandemisë në sistemin shëndetësor dhe në ekonomi do të vazhdojnë të ndihen. Nisja e vaksinimit, e shoqëruar me përmirësime në drejtim të pritjeve, konsumit dhe tregtisë, gjithashtu do të ndihmojë në ruajtjen e këtij momenti, por vendet duhet të mbeten vigjilente në përpjekjet e tyre për të prezantuar dhe përforcuar politika që mundësojnë rritje ekonomike, mbrojnë rezultatet në fushën e shëndetësisë dhe rrisin kapitalin njerëzor", ka deklaruar Van Gelder.

Sipas Bankës Botërore, ekonomia e Kosovës ka shënuar tkurrjen e saj të parë në vitin 2020, që u nxit nga një rënie domethënëse e eksporteve të shërbimeve të udhëtimit, të ndërlidhura me diasporën dhe nga rënia e investimeve. "Tkurrja u zbut nga masat mbështetëse qeveritare dhe nga rritja e remitancave dhe eksporteve të mallrave. Deficiti buxhetor u rrit më shumë se dyfish në vitin 2020, duke arritur 7.6 për qind të BPV-së në 2020, nga 2.9 për qind në 2019, i nxitur nga rënia e të hyrave dhe nga kostoja e masave për mbështetjen e



rimëkëmbjes. Sektori financiar i Kosovës e përballoi mirë pandeminë. Deri në fund të vitit 2020 mjaftueshmëria e kapitalit ishte mbi kërkesat rregullatore dhe norma e kredive joperformuese u rrit pak krahasuar me një vit më parë", është thënë në raportin e BB-së. Referuar këtij raporti, rimëkëmbja ekonomike do të jetë graduale edhe në Kosovë. "Rimëkëmbja do të udhëhiqet nga një rritje e eksporteve dhe e konsumit. Rritja ekonomike parashikohet të mbetet në mbi 4 për qind në periudhën

afatmesme. Perspektiva e parashikuar bazohet mbi supozimet e relaksimit të kufizimeve të lëvizjes së udhëtarëve ndërmjet Evropës dhe Kosovës, pa masa të mëtejshme të rrepta të lëvizjes për frenimin e pandemisë në vend, një ringjallje të rritjes në Eurozonë dhe një rritje në çmimet e metaleve bazë dhe mineraleve", është thënë në raportin e BB-së.

Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, ka thënë se aktiviteti

ekonomik pritët të rifillojë në vitin 2021. Referuar këtij raporti, pandemia ndërpreu progresin e arritur gjatë një dekade në vendet e rajonit në rritjen e të ardhurave dhe uljen e varfërisë, ndërkohë që tregjet e punës në Ballkanin Perëndimor kanë mundur ta rikuperojnë vetëm gjysmën e vendeve të punës të humbura për shkak të pandemisë, duke lënë të papunë një numër të lartë personash dhe duke i detyruar shumë të tjerë ta braktisin tërësisht tregun e punës.

Transformimi i pronës shoqërore nuk ka alternativë

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 PRILL - Pavarësisht prej të metave që e kanë karakterizuar procesin e privatizimit në vend, transformimi i pronës shoqërore dhe publike në atë private në Kosovë nuk duhet të ketë alternativë, megjithatë nevojitet koordinim i brendshëm ndërinstitucional, si dhe me hisedarë të tjerë për rishikimin e mundshëm të politikave të privatizimit. Kjo u tha në forumin e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mbi të Ardhmen e Privatizimit, me deputetë, drejtues të Agjencisë së Privatizimit dhe njohës të ekonomisë.

Kryesuesi i Komisionit Parlamentar për Ekonomi, deputeti Ferat Shala, ka shprehur shqetësimet e tij lidhur me ndërhyrjet e ekzekutivëve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit si një agjenci e



pavarur e cila i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai u shpreh pro shqyrtimit të politikave që lidhen me procesin e privatizimit, duke theksuar edhe nevojën e koordinimit me sektorin privat për këtë çështje. Po ashtu, Shala ka thënë se qeveria e re duhet të ketë një strategji të qartë sa i përket privatizimit të ndërmarrjeve

publike. Ai ka thënë se asetet shoqërore dhe shfrytëzimi i tyre duhet të kihet parasysh gjatë ndryshimit të Ligjit për Investimet Strategjike.

Drejtori menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Valon Tolaj, ka theksuar se institucioni që ai drejton angazhohet për përmbylljen e procesit të privatizimit. Sipas tij, ky proces

nuk mund të përfundojë nëse nuk ka komunikim ndërinstitucional, duke përfshirë këtu edhe komunikimin me qeverinë, komunat, por edhe me gjykatat. Tolaj ka theksuar se gjysma e aseteve shoqërore janë privatizuar, ndërsa vlera e aseteve të paprivatizuara është më e vogël se vlera e aseteve që janë transformuar deri më tani. Ai ka

vlerësuar se shqetësueset për AKP-më janë edhe në vonesat në gjykata.

Në anën tjetër, Safet Gërxhaliu, njohës i ekonomisë, ka theksuar se politizimi i proceseve po i ngadalëson ato. Duke qenë se pika më e dobët në Kosovë është sundimi i ligjit, këtë pasojë, sipas Gërxhaliut, po e bart edhe procesi i privatizimit.

CERN dhe FERMILAB kërkojnë forcën e pestë fundamentale të fizikës, që tashmë është zbuluar nga fizikani Naim Krasniqi (3)

Lidhshmëria në mes të laboratorit të CERN-it dhe atij të Fermilabit



Nga: Naim KRASNIQI, fizikan

Bazuar në të dhënat e tyre të publikuara nga CERN më 23/03/2021 dhe FERMILAB më 07/04/2021 duke mos hyrë në detaje të eksperimenteve të tyre por në rezultatet e tyre shihet qartë se të dyja qendrat hulumtuese shkencore paralajmërojnë rënien e modelit standard të fizikës së grimcave që ndërlidhet me grimcën muon, si dhe dy qendrat hulumtuese shkencore flasin për zbulimin e 1) Një grimcë të re apo 2) Interaksion të ri fundamental të fizikës.

Prandaj ka një ngjashmëri në mes të dy qendrave hulumtuese shkencore CERN dhe FERMILAB me rezultatet e tyre shkencore. Të dyja qendrat kanë kryer eksperimente me të njëjtat grimca muone dhe të dyja qendrat shkojnë drejt rënies së modelit standard të fizikës së grimcave dhe paralajmërojnë ardhjen e një fizike të re.

Rënia e modelit standard të fizikës së grimcave dhe ardhja e një fizike të re

Bazuar në raportet shkencore të këtyre dy qendrave për hulumtime shkencore CERN dhe FERMILAB mbi rezultatet eksperimentale të tyre, mund të themi se: a) Nëse del e vërtetë se kanë gjetur një grimcë të re që nuk është në modelin standard të fizikës së grimcave, do të thotë se kanë gjetur grimcën e 13 e cila bashkëvepron me të gjitha grimcat në univers. Kjo jep për të kuptuar se duhet të ndërrohet

modeli standard i fizikës së grimcave dhe të shkohet drejt një fizike të re.

Sqarimi i parë mbi zbulimin e grimcës së re

Edhe pse grimcës së 13 ende nuk i dihet emri i saktë apo grimca e 13 përbëhet nga një grimcë ashtu sikur theksohet në raportet që vijnë nga CERN-i dhe FERMILAB-i, por me rëndësi është të sqarohet se kjo grimcë a është artificiale e prodhuar në laborator eksperimental të CERN-it apo FERMILAB-it apo është një grimcë e zbuluar në natyrë nga këto dy qendra hulumtuese. Këto dy fenomene janë diametralisht të kundërta sepse në laboratore përdoret dhuna artificiale kurse në natyrë dhuna natyrale dhe assesi nuk bënë të përzihen njëra me tjetrën, për faktin se rezultatet quhen të impunuara dhe nuk janë natyrale.

b) Nëse del e vërtetë se kanë gjetur një interaksion të ri apo një forcë të re në natyrë e cila krijohet nga ndonjë grimcë e panjohur dhe e cila nuk është në modelin standard të fizikës së grimcave, atëherë do të thotë se kanë gjetur forcën e pestë fundamentale të fizikës.

Sqarim i dytë i forcës së re fundamentale të fizikës

Shkencërisht dihet se grimcat formojnë fusha, dhe fushat formojnë forca kjo nuk mund të

mohohet, prandaj nëse kanë gjetur një forcë të re që deri sot nuk është njohur nga fizika kjo i hapë rrugë një force që nuk është tërheqëse, sepse fizika përkatësisht modeli standard i fizikës së grimcave njih vetëm forcat tërheqëse e nuk njih asnjë forcë repulsive. Çka do të thotë se qendrat hulumtuese shkencore CERN dhe FERMILAB kanë gjetur forcën e pestë fundamentale përndryshe forcën repulsive që vepron në univers qoftë në mikrobotë apo në makrobotë.

Qendrat Evropiane për hulumtime bërthamore CERN dhe laboratorit Amerikan i fizikës së grimcave FERMILAB, kërkojnë forcën e pestë fundamentale të fizikës, që është e zbuluar nga unë, Naim Krasniqi

Në jetën e përditshme çdo individ i çfarëdo profesioni qoftë, e mirëpret arritjen e rezultateve të ndryshme shkencore nga cilido shkencëtar apo qendër për hulumtime shkencore. Prandaj edhe unë ngjashëm sikur të tjerët e kam mirëpritur lajmin e publikuar nga këto dy qendra për hulumtime shkencore mbi zbulimin e një grimce të re apo force fundamentale të re.

Gëzimi te unë është edhe më i madh, sepse rezultatet e këtyre dy qendrave shkencore CERN dhe FERMILAB për të cilën

pretendojnë se e kanë zbuluar një grimcë të re apo një forcë të re fundamentale të fizikës në një mënyrë a tjetrën do ta zbardhin të vërtetën se në këtë forcë fundamentale të fizikës brenda të cilës hyjnë dy forca fundamentale, ku njëra vepron në makrobotë dhe tjetra që vepron në mikrobotë është tani e zbuluar. Këto dy forca fundamentale së bashku me tri mikrogrimcat që i shkaktojnë këto forca i kam zbuluar për herë të parë unë, Naim Krasniqi, i lindur në fshatin Lloqan të Komunës së Deçanit. Zbulimin enigmatik të kësaj force fundamentale të fizikës e kam bërë në muajin shkurt të vitit 2013, gjatë testimeve eksperimentale që isha duke i punuar për patantimin e një motori magnetik.

1) Forcën fundamentale të fizikës që vepron në makrobotë e kam pagëzuar Fusha Antimagnetike që vepron si një forcë repulsive në mes trupave qiellorë; 2) Forcën fundamentale të fizikës që vepron në mikrobotë e kam pagëzuar Fusha Antielektrostatike që vepron si një forcë repulsive në mes grimcave në brendësi të atomit; 3) Kurse mikrogrimcat që i formojnë këto forca do të sqarohen në vazhdim.

Edhe pse pothuajse sipas mundësisë sime kam kërkuar mënyra të ndryshme për t'u takuar me personalitete kompetente por edhe me qendra hulumtuese shkencore duke përfshirë edhe ESA - The European Space Agency, CNES Centre national d'études spatiales,

NASA La National Aeronautics and Space Administration që do ta dëgjonin zërin tim mbi këtë zbulim epokal të fushës antimagnetike dhe fushës antielektrostatike, por fatkeqësisht prapë se prapë askush nuk ishte i gatshëm të paktën të më pranojnë e ta dëgjojnë zërin tim, dhe një injorim i tillë mund të ketë lidhje me atë që kam deklaruar në "Epoka e re" në vitin 2019, se shkas i këtyre mund të jenë emri mbiemri dhe origjina ime. Kështu që, duke iu falënderuar gazetës "Epoka e re" e cila shprehi gatishmërinë për të më dhënë një hapësirë për botimin e një serie të gjatë të shkrimeve shkencore për këtë zbulim, duke informuar kështu edhe opinionin kombëtar e ndërkombëtar. Këto zbulime të miat shkencore së pari u botuan në vitin 2016 (nga data 20/09/2016 deri më 26/09/2016) me titullin: "Zbulimi eksperimental i forcës shtytëse në mes trupave qiellorë është fundi i ligjeve të fizikës nga struktura e atomit deri te universi".

Po ashtu edhe studimet e mia u botuan edhe më 16/07/2019 deri më 31/07/2019 me titullin: "Fizika simetrike udhëtim drejt universit", kurse "Fizika dhe kimia simetrike udhëtim drejt universit" u botuan po ashtu në "Epoka e re" nga data 15/01/2020 deri më 04/02/2020, dhe së fundmi botimet me titull: "Fizika simetrike është rruga e vetme për parandalimin e shpërndarjes së koronavirusit" nga data 06/04/2020 deri më 18/06/2020. (Vijon)

Konstituohet Këshilli i Arbitrazhit Sportiv të Kosovës (KAS)

Prishtinë, 27 prill - Këshilli i Arbitrazhit Sportiv të Kosovës (KAS), i dalë nga Asambleja e 8-të Zgjedhore e Komitetit Olimpik të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e parë konstituive të tij. I pranishëm në takim ishte edhe presidenti i Komitetit Olimpik

të Kosovës, Ismet Krasniqi, i cili i përgëzoi anëtarët për emërimin në KAS dhe iu uroi punë të mbarë gjatë ciklit olimpik 2021-2024, sa zgjat mandati i anëtarëve të KAS-it. Më pas, këshilli në prani të sekretarit të përgjithshëm të KOK-ut, Shasivar Haxhijaj,

vazhdoi mbledhjen, duke diskutuar hapat e mëtejshme. Anëtarët u pajtuan që në takimin e radhës të zgjedhet kryetari, nënkryetari dhe sekretari i KAS-it. Bazuar në Rregulloren e KAS-it, të miratuar nga Asambleja e Punës, e mbajtur më 26

dhjetor 2020, të gjithë anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv janë juristë me përvojë. Këshilli përbëhet nga: Eroll Salihu, Imer Beka, Jeton Oruqi, Korab Sejdiu, Visar Alimehaj, Ilir Krasniqi, Fisnik Salihu,



Jehona Shyti, Armend Krasniqi.

PSG - City ndajnë mejdanin në gjysmëfinalen e parë

Paris, 27 prill - Paris Saint-Germain dhe Manchester City do të përballen sonte (e mërkurë) në "Parc des Princes" në kuadër të gjysmëfinalës së parë të Ligës së Kampionëve. Ylli i PSG-së, Neymar, ka thënë se prioritet për skuadrën franceze është Liga e Kampionëve. Brazili ka premtuar maksimumin e të gjithëve për të fituar këtë trofe. "E dimë që për PSG-në prioritet është Liga e Kampionëve. Do të bëjmë gjithçka për ta fituar. Shumë gjëra ndodhen sezonin e kaluar, në nivelin teknik, jemi këtu për të vazhduar me fitore. Klubi është rritur shumë, është duke avancuar, është pjesë e 4-6 skuadrave më të mira në botë. Jemi në gjysmëfinale dhe do të bëjmë çmos për të fituar. Manchesteri është skuadër shumë e vështirë, njësoi si Bayern, por ne do të bëjmë gjithçka për ta fituar ndeshjen", ka thënë Neymar. PSG-ja u kualifikua në gjysmëfinale pasi e eliminoi Bayern Munchenin në çerekfinale. Ndeshjen e parë Parisi e fitoi në Gjermani me rezultat 2-3, kurse



Formacionet e mundshme:

Paris Saint-Germain: Navas; Florenzi, Marquinhos, Kimpembe, Diallo; Gueye, Paredes; Di Maria, Verratti, Neymar; Mbappe.
Manchester City: Ederson; Walker, Dias, Stones, Cancelo; Rodri, Gundogan, De Bruyne; Mahrez, Silva, Foden.

në të dytën pësoi humbje si vendas 0-1, por u kualifikua falë golave të shënuara si mysafirë. Në anën tjetër, edhe City e eliminoi një skuadër gjermane. Bëhet fjalë për Borussia Dortmundin. Ndërsa mesfushori i PSG-së, Ander Herrera, e ka cilësuar gjigantin spanjoll si klubin më të mirë në histori të futbollit. "Real Madridi është klubi më i mirë në histori të futbollit. Ky është fakt. Ata që janë

në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve nuk më befasojnë mua. Ka një lidhje të veçantë mes Realit dhe Ligës së Kampionëve", ka thënë Herrera. Ndeshjen e parë në Angli, City e fitoi me rezultat 2-1, kurse edhe ndeshjen e dytë në Gjermani e fitoi me rezultat identik. Juan Bernat është mungesa e vetme e skuadrës franceze për këtë ndeshje, derisa anglezët janë të kompletuar.

Tjetër humbje për Utah Jazzin, mposhten edhe clippersat, fitojnë lakersat

Minneapolis, 27 prill - Në NBA ishte mbrëmje surprizash. Kryesuesit e Konferencës së Perëndimit, Utah Jazz, pësuan një tjetër humbje duke vendosur në diskutim vendin e parë. Skuadra nga Salt Lake City u mposht në Minneapolis nga Minnesota Timberwolves me rezultat 105-104. D'Angelo Russell me 27 pikë dhe 12 asistime, por edhe Karl Anthony Towns me 21 pikë dhe 11 rebounde ishin dy më të mirët mbi parket për Timberwolves që arriti të merrte një fitore të madhe në sekondat e fundit ndaj Utah Jazz. New Orleans Pelicansi ndali hovin prej katër fitoresh radhazi të Los Angeles Clippersit, duke e mposhtur me



rezultat 120-103. Kjo sfidë mori drejtim që në periodën e parë me Pelicansin që ishin më lart dhe kishin më shumë dëshirë për ta marrë fitoren. Zac Williamson me 23 pikë, Lonzo Ball dhe Eric Bledsoe me nga 18 pikë, ishin tre muskuterët e New Orleansit në këtë sfidë që e udhëhoqën drejt suksesit. U rikthye te fitorja Los Angeles Lakersi që i dha

fund krizës prej 3 humbjesh rresht duke triumfuar në Florida përballë Orlando Magicut me rezultat 114-103. Gjermani Denis Schroder me 21 pikë, por edhe Anthony Davis me 18 pikë, 8 rebounde e 3 asistime ishin ata që morën për dore skuadrën kaliforniane në këtë duel, ndërkohë që Orlando pësoi humbjen e 6-të rresht. 24 pikët e Luka Donçiqit nuk mjaftuan për Dallas Mavericksin që u mposht në transfertën ndaj Sacramento Kingsit me rezultat 113-106. Një disfatë që gjithsesi e mban Dallasin në vendin e 6-të në Perëndim, pozicion që e kualifikon në fazën e dytë të "play-off"-it ekipin teksan.

SHKURT

Nagelsmann, trajner i ri i Bayernit

Bayern Munchen e ka zgjedhur pasardhësin e trajnerit Hansi Flick, i cili do të largohet në fund të këtij sezoni. Bëhet fjalë për Julian Nagelsmann që edhe zyrtarisht është trajneri i ri i skuadrës "bavareze" me të cilët ka firmosur një kontratë deri në 30 qershor të vitit 2026. Marrëveshja me Leipzigun është arritur dhe Bayerni nuk ka ngurruar ta bëjë publik emërimin e 33-vjeçarit si trajner të ri të skuadrës duke filluar nga 1 korriku. Nuk bëhet e ditur shuma që do të derdhë Bayerni në arkat e Leipzigut, por me siguri do të jetë një shifër e përafërt me 20 milionë euro. Nagelsmann është një nga trajnerët që ka firmosur një prej kontratave më afatgjata në historinë e Bayern Munichut. Kontratë 5-vjeçare kjo edhe për faktin se ai është në një moshë shumë të re. Me Nagelsmann Bayerni do të synojë ta vazhdojë rrugën e sukseseve të lënë përgjysmë nga Hansi Flick i cili e mbylli dy vjet para se t'i skadonte kontrata aventurës së tij me kampionët e Gjermanisë, ndërsa e ardhmja e tij me shumë gjasa do të jetë në krye të përfaqësueses gjermane.

Fury: Dueli me Joshuan zhvillohet në korrik

Boksieri britanik Tyson Fury, kampion bote në peshën e rëndë në kategorinë WBC, ka konfirmuar se përballja e tij me Anthony Joshuan, kampionin tjetër të botës të këtij Divizioni (WBO, WBA e IBF), do të zhvillohet në korrik të këtij viti. Në një intervistë për "Fight Hub TV", britaniku ka deklaruar: "Po, dueli me Joshuan do të zhvillohet në korrik". Me shumë gjasa kjo përballje do të zhvillohet në Arabinë Saudite më 7 korrik. Data 7 korrik ishte një nga 3 alternativat që pat thënë Bob Arum, menaxheri i Fury, bashkë më 24 dhe 31 korrik. Një sfidë e shumëpritur kjo me Joshuan, që do t'i unifikojë titujt kampionë bote në peshën e rëndë.

Mestre: Messi do ta vazhdojë me Barçën

Lionel Messi do të qëndrojë në Barcelonë edhe pas këtij sezoni, sepse është i gatshëm t'i vërë synimet sportive para atyre financiare, sipas ish-zëvendëspresidentit të klubit katalonas, Jordi Mestre. Messi mund t'i mbushë xhepat edhe gjëkund, sepse klube të pasura si Manchester City dhe Paris Saint-Germain kanë shprehur interesim të madh për shërbimet e tij. Por triumfi në Kupën e Mbretit së fundmi dhe titulli i mundshëm në La Liga këtë sezon mund ta bindin 33-vjeçarin të vijojë të jetë njeri i vetëm i një klubi. I pyetur nëse Messi mund ta largohet në verë, kur edhe i mbaron marrëveshja me klubin, Mestre ka deklaruar: "Messi do të vazhdojë por, nëse largohet, nuk do ta bëjë për para".

Buffoni largohet nga Juve, jo edhe nga futbollit

Gianluigi Buffon, ndonëse në moshë 43-vjeçare, ende nuk ka ndërmend të largohet nga futbollit i luajtur. Në Itali thonë se portieri do të largohet nga Juventus pas përfundimit të sezonit, teksa pritet ta shikojmë me një skuadër tjetër. "Tuttosport" shkruan se janë pesë klubet që duan ta marrin Buffonin, i cili ende mund të japë në futboll. Eintracht Frankfurti, Sportingu i Lisbonës, Galatasaray, Dinamo Kievi dhe Olimpiacos janë pesë skuadrat që kanë shfaqur interesim për ta marrë Buffonin. Buffoni në shumicën e ndeshjeve ka qëndruar në stol me Juventusin këtë sezon për shkak se portier i parë është Wojciech Szczesny.

Pioli: Kam pritur më shumë ndaj Lazios

Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, ka thënë se ka pritur më shumë nga skuadra e tij në përballje me Lazion, të cilën kuqezinjët e humbën me rezultat 3-0. "Siç ndodh shpesh në këto lojëra, kundërshtarët tanë dolën më mirë në

rastet vendimtare. Ne kemi luajtur më mirë në pjesën e parë dhe kemi pasur mundësi për të barazuar. Kam pritur më shumë nga skuadra, sepse ne kemi cilësi për të bërë më mirë, por pas golit të dytë u bë më e komplikuar", ka thënë Pioli

për "Sky Italia".

Goli i dytë ishte i diskutueshëm, pasi Lucas Leiva dukej sikur e fauloi Hakan Calhanoglu gjatë ndërtimit të aksionit, por gjyqtari i qëndroi vendimit të tij original edhe pasi e pa atë në VAR.

"Sinqerisht nuk e kuptoj se si kjo nuk u dha si faull ndaj Calhanoglu. Ai shkoi ta shihte përsëri, nga përsëritja është e pamundur të thuash Leiva nuk e kap Calhanoglu dhe e humbet topin tërësisht", ka shtuar trajneri i Milanit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Bermas Therm " Sh.p.k Mazgit, Obiliq, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e rrjetës termoizoluese në Zonën Kadastrale Llazarevë, Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.05.2021 në ora 11:00 në restorantin "Masa" pronë e investitorit të kompanisë, Restorani gjendet ne km e gjashtë të rrugës magjistrale në drejtimin Prishtinë-Obiliq-Mitrovicë do të organizohet debat publik nga Kompania " Bermas Therm " Sh.p.k. Mazgit, Obiliq në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e rrjetës termoizoluese në Zonën Kadastrale Llazarevë, Obiliq.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:
<https://us05web.zoom.us/j/82025194292?pwd=NTZqWmxwS09sNm4vNXp3VVdQbVBJUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Bermas Therm " Sh.p.k Mazgit, Obiliq, për fabrikën për prodhimin e rrjetës termoizoluese në Zonën Kadastrale Llazarevë, Obiliq.

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Leutrim Hoxha shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt " 11 Marsi " Prizren.

▶ Herolind Collaku shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën dhe diplomën shmlt " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Mark Baftijari BI shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit 811041665 Prizren.

▶ Fatmir Ymeraj shpall të pavlefshme dëftesat shfmu " Hysni Temaj " Prizren.

▶ Arber Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Avdyl Frasheri " Prizren.

▶ Drilon Badalli shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

▶ Halit Ramadani shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt " 11 Marsi " Prizren.

▶ "Austria Praemix Kosova" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811513242 si dhe nr. 330474495.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.



Hysen Beqa lindi në Mollë të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë përkëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijojnë shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

Albin Mehmeti


5.99€



SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!


Unë jam gruaja më e fortë në botë!



6.99€



UNË, KUFOMA E ARDHSHME



Kaltrina Pacolli





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

